

LIGJ
Nr.9780, datë 16.7.2007

PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME

(ndryshuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010¹, nr. 10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr. 183/2014, datë 24.12.2014; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Neni 2

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe i përgjegjësitë të tyre.

Neni 3

Organizimi i inspektimit

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse.
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

1. Autoritetet kontraktore/ organi shtetëror i autorizuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas rastit, depozitojnë pranë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kopje të plota të marrëveshjeve koncesionare në fuqi, ku parashikohen të kryhen ose janë kryer ndërtime në mjedise, sipas nenit 10/2 të këtij ligji dhe, kur i disponojnë në dosje, edhe lejet përkatëse, të dhëna për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të të dhënave që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni e të materialeve arkivore që administron, krijon regjistrin e të dhënave për ndërtimet e kryera ose eventuale në mjedisin e caktuar, sipas nenit 10/2 të këtij ligji, në të cilin do të kryejë përditësime pas çdo inspektimi, si dhe ka detyrim për mirëmbajtjen e tij. Kjo dispozitë është parashikuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010.

Neni 4

Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore

(shtuar një paragraf me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse.

Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.

Neni 5

Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore

(ndryshuar shkronja “e” dhe shtuar shkronja “ë” me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; shtuar një paragraf me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;

ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.

Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit.

Neni 6

Bashkëpunimi dhe delegimi i përgjegjësive dhe detyrave për inspektimin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës
(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 7

Inspektorati ndërtimor e urbanistik i qarkut
(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 8

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion buxhetor, publik, me statusin e personit juridik, i specializuar në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në varësi të ministrisë përgjegjëse për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

3. Struktura dhe organika e inspektoratit qendror miratohet nga Kryeministri sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Përpara dërgimit të propozimit merret mendimi i detyrueshëm i Inspektoratit të Përgjithshëm.

4. Punonjësit e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit gëzojnë të drejtën e pajisjes me armë dhe të përdorimit të tyre sipas legjislacionit përkatës.

5. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe shenjat dalluese të veçanta të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8/1

Marrëdhëniet e ministrit me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit
(shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Ministri është autoriteti, i cili:

a) informohet për të gjithë veprimtarinë e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, dhe i kërkon kryeinspektorit të raportojë për ushtrimin e përgjegjësive dhe përmbushjen e detyrave të tij e të inspektorëve në varësi të tij, si dhe të inspektorateve vendore, në përgjithësi, nëpërmjet të dhënave statistikore, ose në lidhje me ndonjë çështje të veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) kërkon performancë të lartë të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për realizimin e objektivave të përcaktuar;

c) vlerëson dhe merr masat përkatëse brenda fushës së tij të përgjegjësisë, për ankesat e subjekteve të interesuara, ndaj kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Neni 8/2

(shtuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Ministria përgjegjëse i paraqet për mendim Inspektoratit të Përgjithshëm projektprogramin buxhetor të detajuar të shpenzimeve për strukturat e miratuara të inspektimit brenda datës 15 prill të vitit paraardhës.

2. Ministri përgjegjës ka akses në sistemin unik elektronik të inspektimit për marrjen e informacionit në kohë reale mbi veprimtarinë e inspektimit për inspektoratin qendror, të cilin e mbulon.

Neni 9

Përgjegjësitë e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

(shtuar shkronja "dh" me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010 dhe ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

a) ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare dhe në territor, në kuptim të këtij ligji, janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë dhe komunikimit elektronik, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, vija bregdetare, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet, digat e dambat, tokat bujqësore, spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, si dhe ato të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit e me akte nënligjore ose ligje të tjera;

b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore;

c) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe merr masat përkatëse, sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

ç) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

d) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

dh) ushtron përgjegjësitë e parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Neni 9/1

(shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:

a) të ushtrojë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtime/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

b) të ushtrojë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose dokumentet e planifikimit në fuqi.

2. Përgjegjësia, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, ushtrohet kur:

a) kërkohet nga vetë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore ose nga kryetari përkatës i saj, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati vendor nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për ligjshmërinë ose jo të ndërtimit/punimit, në përputhje me afatet dhe procedurat

ligjore;

c) vendimi i inspektoratit vendor për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

3. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, për të provuar kundërligjshmërinë e ndërtimit, kryen inspektim në ndërtimin/punimin, objekt inspektimi, sipas nenit 12, të këtij ligji, dhe në rast se në përfundim të inspektimit konstaton se ndërtimi është i kundërligjshëm, vepron sipas nenit 13 të këtij ligji.

4. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për ushtrimin e përgjegjësisë sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, bashkërendon punën me autoritetet përgjegjëse përkatëse të planifikimit të territorit në nivel qendror.

Neni 9/2

(shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka përgjegjësi ekskluzive, në përputhje me këtë ligj, për ndërtimet e kundërligjshme, të përhershme apo të përkohshme, të ngritura mbi sipërfaqen ujore, përkatësisht mbi shtratin e lumenjve, liqeneve dhe deteve, pavarësisht nëse kanë ose jo pikë lidhjeje me bregun e lumit, liqenit ose detit. Në rastet kur inspektorati i mbrojtjes së territorit në nivel vendor konstaton ekzistencën e ndërtimeve të tilla ia përcjell çështjen për kompetencë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit kryen inspektimin, sipas pikës 1, të këtij neni, në njërën nga format e mëposhtme:

a) periodik, të pakën 1 herë në vit, në çdo mjedis të vënë në dispozicion të të tretëve nga shteti shqiptar, në bazë të marrëveshjeve koncesionare shtetërore;

b) brenda 15 ditëve pune, kur autoriteti kontraktor ose organi shtetëror i autorizuar, sipas rastit, depoziton një kërkesë me shkrim për rikthimin e ligjshmërisë së mjediseve të dhëna me koncesion shtetëror;

c) brenda 15 ditëve pune, kur administrata detare njofton se në mjediset ujore të porteve të shpallura kryhen ndërtime/punime pa lejen përkatëse ose në kundërshtim me parashikimet e bëra në to;

ç) me kërkesë me shkrim të kryetarit të njësisë vendore.

Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, përfshijnë edhe rastet e koncesioneve për ndërtime digash, hidrocentralesh dhe hidrovoresh.

3. Ministrinë e linjës depozitojnë në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e marrëveshjes koncesionare, kopje të plota të këtyre marrëveshjeve dhe përcaktime konkrete të mjediseve, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, ku parashikohet të operojë koncesionari.

4. Në përfundim të çdo inspektimi, sipas pikës 2, të këtij neni, kopja e plotë e procesverbalit dhe/ose vendimit përkatës i dërgohet, për dijeni, autoritetit kontraktor ose organit shtetëror të autorizuar, sipas rastit, për inspektime, në përputhje me shkronjën “a” dhe çdo kërkuesi për inspektime, në përputhje me shkronjat “b”, “c” ose “ç”, të pikës 2, të këtij neni.

Neni 10

Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/1

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/2

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/3

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 11

Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Neni 12

Ushtrimi i kontrollit

(shfuqizuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014; zëvendësuar fjalë në pikën 1, shtuar 1/1, 1/2 dhe 1/3, ndryshuar pikat 5, 6 dhe 7 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Për ushtimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se tre inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.

1/1. Veprimtaria e inspektimit që kryhet nga inspektorati qendror dhe ai vendor detyrimisht do të kryhet përmes sistemit unik elektronik *“e-Inspektimi”* dhe do të dokumentohet dhe administrohet nëpërmjet sistemit unik elektronik *“e-Inspektimi”*.

1/2. Procedura administrative e inspektimit fillon me lëshimin e autorizimit nëpërmjet sistemit unik elektronik *“e-Inspektimi”*.

1/3. Inspektimi i bëhet i ditur subjektit nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit për kryerjen e inspektimit, me mjete elektronike (*online*) ose në forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në çdo rast jo më vonë se 7 ditë përpara fillimit të procedurës së inspektimit.

2. Kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi.

3. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar.

4. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, zhvilluesi, ndërtuesi, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit etj.) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e punimit/ndërtimit janë të detyruar të lejojnë kryerjen e kontrollit, të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga aktet normative në fuqi, si dhe të ndihmojnë në shqyrtimin e tij.

5. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit, i cili ngarkohet në sistemin elektronik të inspektimit dhe nënshkruhet si nga inspektorët që kryejnë kontrollin, ashtu edhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i përcillet elektronikisht subjektit të kontrolluar.

6. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa e inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i dërgohet në rrugë elektronike një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit.

7. Nëse identiteti i subjektit të kontrolluar nuk dihet, një kopje e procesverbalit të inspektimit afishohet për 5 ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

8. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë zbatimin e objektit në terren, sipas lejes së ndërtimit të dhënë nga autoriteti përkatës i planifikimit, si dhe të kontrollojnë dosjen me dokumentacionin teknik e ligjor të objektit;

b) të kryejnë një apo më shumë kontrole në të njëjtin objekt, sipas problematikave teknike e ligjore të objektit, që ndërtohet;

c) të përfshijnë në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve.

9. Kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së, gjatë ushtrimit të kontrollit të parashikuar, sipas këtij neni, në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësiave të parashikuara në këtë ligj, nuk janë të detyruar të kryejnë asnjë lloj njoftimi paraprak pranë inspektoratit përkatës të njësisë vendore dhe/apo organit përkatës të planifikimit.

10. Pavarësisht sa më sipër, kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së, gjatë ushtrimit të kontrollit të parashikuar, sipas këtij neni, kanë të drejtë që, krahas verifikimit në vend të situatës ndërtimore, të inspektojnë, të kërkojnë dhe të kryejnë të gjitha verifikimet e nevojshme pranë autoritetit përkatës të planifikimit, të cilët janë të detyruar të krijojnë të gjitha lehtësitë për verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe të japin të gjitha shpjegimet përkatëse dhe çdo dokume-ntacion të kërkuar. Në rast se në përfundim të inspektimit, sipas kësaj pike, konstatohen shkelje, kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së marrin masat përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 13

Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet

(shfuqizuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Sipas afateve të përcaktuara në ligjin për inspektimin, nga mbajtja e procesverbalit të inspektimit përmes sistemit elektronik të inspektimit, ku reflektohen gjetjet që përbëjnë kundërvajtje administrative, të cilat ndëshkohen me gjobë, trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe/ose trupa inspektuese e inspektoratit vendor të mbrojtjes së territorit nxjerr vendimin përfundimtar të inspektimit për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga trupa inspektuese.

2. Në rastet kur kundërvajtjet administrative të gjetura ndëshkohen me pezullim të punimeve dhe prishje të objektit, trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe/ose trupa inspektuese e inspektoratit vendor të mbrojtjes së territorit nxjerr vendimin përfundimtar të inspektimit për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

3. Pas plotësimit dhe mbylljes së listës së verifikimit, trupa inspektuese plotëson procesverbalin e inspektimit duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e shqyrtuar. Vendimi përfundimtar merret në momentin e administrimit nga trupa inspektuese të fakteve dhe rrethanave që justifikojnë gjetjet e pasqyruara në procesverbal.

4. Dënimi me pezullim të punimeve në ndërtim merret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak për marrjen e vendimit përfundimtar për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës ose për marrjen e vendimit me dënimin për prishjen e objektit.

5. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë.

Një dënim i tillë merret në rastet kur:

a) subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet trupës së inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit, që ka të bëjë, sipas rastit, me projektimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe/ose kolaudimin e punimeve të ndërtimit;

b) mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;

c) plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;

ç) vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

6. Dënimi me pezullim të punimeve në ndërtim shoqërohet me dënim me gjobë sipas parashikimeve ligjore, si dhe, kur është rasti, me kallëzimin penal apo kërkesën për heqje të licencës subjektit kundërvajtës.

7. Gjatë periudhës së pezullimit të punimeve në ndërtim, subjekti ndërtues është i detyruar të ndërpresë punimet në objekt dhe inspektorati vendor përkatës është përgjegjës për zbatimin e këtij dënimi. Në rastet kur dënimi merret nga trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror, kjo i dërgon brenda 5 ditëve vendimin e pezullimit inspektoratit vendor, i cili e zbaton atë brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

8. Trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin në nivel qendror dhe trupa inspektuese e inspektoratit vendor të mbrojtjes së territorit marrin vendimin për shkeljen e konstatuar brenda afatit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

9. Në përfundim të inspektimit, trupa inspektuese përpara marrjes së vendimit i shpjegon subjektit të inspektimit shkeljet e konstatuara, nëse ka të tilla, dhe vendimin që synon të marrë.

10. Në rastin kur nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore gjatë procedurës së inspektimit, për kundërvajtjet administrative, të cilat ndëshkohen me gjobë, trupa inspektuese mbyll procesverbalin dhe merr vendim përfundimtar në vend. Procesverbali dhe vendimi përfundimtar.

Neni 14

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Kundër vendimit të trupës inspektuese të strukturës përgjegjëse për inspektimin dhe atij të njësisë vendore lejohet ankim administrativ, i cili paraqitet nga subjekti i inspektimit kundër vendimit përfundimtar të inspektimit dhe dorëzohet e shqyrtohet në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, sipas ligji për inspektimin.

Kundër vendimit të trupës inspektuese të njësisë vendore lejohet ankimi administrativ, i cili paraqitet nga subjekti i inspektimit në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Pas ezaurimit të ankimit administrativ, subjektit i lind e drejta të bëjë ankim gjyqësor.

Neni 15

Kundërvajtjet administrative të kryeinspektorëve/inspektorëve dhe gjobat

(shtuar pika 7 me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; ndryshuar pika 7 dhe shtuar pika 8 ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Veprimet ose mosveprimet e krye-inspektorëve/inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve të IKMT-së, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit

dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale ose jo, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Mosushtrimi i funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në masën 300 000 lekë.

2. Shtrembërimi i rezultateve të kontrollit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, në masën 400 000 lekë.

3. Mosrespektimi i afateve për marrjen e vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 200 000 lekë.

4. Mosrespektimi i afateve të zbatimit të vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 300 000 lekë.

5. Moszbatimi i vendimit të pezullimit të punimeve në ndërtim brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, në masën 150 000 lekë.

6. Mosrespektimi i afatit për dhënien e informacionit dhe pengimi në përmbushjen e detyrave, në masën 100 000 lekë.

7. Mosparaqitja e kërkesës për heqje licence të mbikëqyrësit të punimeve, pranë organeve kompetente, në masën 500 000 lekë.

Gjoha vendoset me vendim të kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe përbën titull ekzekutiv.

Neni 16

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014; ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Unifikimi i praktikave të inspektimit të mbrojtjes së territorit nga strukturat përgjegjëse të inspektimit në ushtrimin e kompetencave të tyre do të jetë në përputhje me ligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Dispozitë kalimtare për Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar transformohet në Inspektorat Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Struktura e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit miratohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Deri në daljen e urdhrit për strukturën, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit do të funksionojë sipas strukturës ekzistuese.

4. Praktikant dokumentare administrative, të cilat janë në shqyrtim nga INUK-u, i kalojnë për administrim e ndjekje në vazhdim të tyre nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Neni 18

Krijimi i inspektorateve ndërtimore e urbanistike të njësive vendore

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 19

Shfuqizime

Ligji nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, i ndryshuar dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

Neni 20

Shfuqizime

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, vendimi nr. 862, datë 5.12.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare

(e parashikuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5423, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**